

LIGJ
Nr. 16/2021

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË KONCESIONIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE SHOQËRISË KONCESIONARE “TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT”
SHPK, “PËR NDËRTIMIN, VËNIEN NË PUNË, OPERIMIN DHE
MIRËMBAJTJEN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR ‘NËNË TEREZA’,
TIRANË”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9312, DATË 11.11.2004, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Koncesionare “Tirana International Airport” sh.p.k., “Për ndërtimin, vënie në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar ‘Nënë Tereza’, Tiranë”, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004, të ndryshuar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 8.2.2021.

AKT MARRËVESHJE
(NDRYSHIM KONTRATA TË TJERA)

Nr. repertori: 461

Nr. koleksioni: 188

Kamzë, më 26.1.2021

**NDRYSHIMI I MARRËVESHJES SË KONCESIONIT, TË LIDHUR NË DATËN
15.10.2004, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
SHOQËRISË “TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT” SHPK, NDRYSHUAR MË
1.4.2016**

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë, Anila Denaj, atësia Spiro, amësia Qane, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë “Pjetër Budi”; nd. 29; H. 13; ap. 41; Njësia Administrative nr. 2; Njësia Bashkiake nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 18.9.1973, gjendja

civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 027856846 dhe nr. personal H359180230, dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë (së bashku “Organi Shtetëror i Autorizuar”/“OSHA”) nga Etjen Xhafaj, atësia Vullnet, amësia Merita, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë “Njësia nr. 3, “Sitki Çiço”; nd. 12/1; H. 1; ap. 1; Njësia Administrative nr. 3; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 6.4.1982, gjendja civile: i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me letërnjoftim ID nr. 028059950 dhe nr. personal 120406180W, me autorizim,

dhe

2. Shoqëria Tirana International Airport sh.p.k., regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve), me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K51612012D, me adresë “Aeroporti Ndërkombëtar ‘Nënë Tereza’”, ndërtesa e administratës, përfaqësuar nga administratori dr. Von Alvensleben Joachim Christoph Constantin, shtetas gjerman, lindur në Celle, lindur më 16.5.1962, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me letërnjoftim ID nr. L6WLF1H5, e cila është themeluar dhe ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Tiranës nr. 32147, datë 20 shtator 2004,

në vijim referuar individualisht si “Palë” dhe së bashku si “Palët”.

Duke pasur parasysh se:

1.1 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe shoqëria koncesionare kanë lidhur marrëveshjen fillestare të koncesionit, më datë 15 tetor 2004 (Marrëveshja fillestare e koncesionit), e ratifikuar përmes ligjit nr. 9312, datë 11 nëntor 2004, “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar ‘Nënë Tereza’, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare” (në vijim referuar si “Ligji i koncesionit të aeroportit”);

1.2 Duke qenë se data e fillimit, siç është përcaktuar në klauzolën 3.5 (Data e fillimit) e marrëveshjes fillestare të koncesionit është identifikuar si 23 prill 2005;

1.3 Duke qenë se palët kanë ndryshuar marrëveshjen fillestare të koncesionit në datën 1.4.2016, ndryshim i cili u ratifikua me ligjin nr. 55/2016;

1.4 Duke qenë se me marrëveshjen për transferimin e kuotave, të datës 1.12.2020, shoqëria “Real Fortress Private Limited”, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë koncesionare, transferoi plotësisht pronësinë mbi kuotat që zotëronte në shoqërinë koncesionare “Tirana International Airport” sh.p.k., të shoqëria “Kastrati Group” sh.a. – NUIS K21711502V;

1.5 Në kuadër të zhvillimit dhe të modernizimit të aeroportit në drejtim të kryerjes së investimeve për modernizimin e infrastrukturës dhe rritjen e cilësisë në ofrimin e shërbimeve në këtë aeroport, zhvillime këto të imponuara nga ndryshimet në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit, flukset e lëvizjes, nevojat teknologjike, efektet negative të pandemisë COVID-19 në industrinë e transportit ajror, adresimit të çështjes së ekuilibrit ekonomik, çështjes së tarifave, shërbimeve në tokë, si dhe ndryshimet në legjislacionin shqiptar, shoqëria koncesionare ka kërkuar pranë autoriteteve shqiptare, ndryshime në marrëveshjen e koncesionit për implementimin e një plani biznesi, i cili synon realizimin e objektivave të mësipërm përgjatë një periudhe tej afatit të marrëveshjes koncesionare, të ndryshuar;

1.6 Duke qenë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga OSHA-ja, ka vlerësuar dhe konsideruar kërkesën e paraqitur nga shoqëria koncesionare për mundësinë e ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit;

1.7 Duke qenë se të dyja palët kanë autoritetin dhe kompetencën ligjore për të nënshkruar këtë ndryshim, siç është parashikuar në mënyrë specifike në klauzolën 37.7 (Ndryshimet) të marrëveshjes fillestare të koncesionit.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh sa më sipër, palët bien dakord të ndryshojnë dispozitat e mëposhtme të marrëveshjes së koncesionit, e ndryshuar:

2. Ndryshimi

2.1 Në klauzolën 1.1 “Përkufizime” bëhen këto ndryshime:

a) Përkufizimi “Propozimi i zgjatimit të pistës” ndryshohet si më poshtë:

“Propozimi i zgjatimit të pistës” është propozimi për zgjatimin e pistës që do të përgatitet nga shoqëria koncesionare, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 4.8/“a” të marrëveshjes “Zgjatimi i pistës”.

b) “ANTA” zëvendësohet me “Albconol”.

c) “DPAC” zëvendësohet me “AAC” dhe ndryshohet si më poshtë:

“është Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë, i themeluar në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe që ka autoritetin dhe përgjegjësitë e përshkruara në ligjin e zbatueshëm ose çdo pasardhës i saj.”.

ç) “Taksë kufiri në dalje” zëvendësohet me “Tarifa për kalimin me avion të kufirit” dhe ndryshohet si më poshtë:

“është tarifa e kufirit në dalje e vendosur në përputhje me ligjin e zbatueshëm.”.

d) “Taksat e mbledhura” ndryshohet si më poshtë:

“është çdo shumë e taksës së vizës dhe/ose e tarifës për kalimin me avion të kufirit në dalje, e mbledhur nga shoqëria në emër të qeverisë së Shqipërisë, në përputhje me pikën 19.1/c (Pagesat për shërbimet e aeroportit) dhe në varësi të të drejtave të kompensimit të veçantë të shoqërisë.”.

dh) “Pagesat për shërbimin e përpunimit në tokë” ndryshohet si më poshtë:

“janë pagesat për shërbimin e përpunimit në tokë të ofruar nga operatori i aeroportit, që tregohen në shtojcën 7 (Pagesat për shërbimet e aeroportit).”.

e) Shtohet një përkufizim me përmbajtjen si vijon: “Sigurimi i kontratës” është garancia e paraqitur në formën e kërkuar, e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë apo shoqëri sigurimesh, sipas përcaktimeve të marrëveshjes koncesionare, me kërkesë të koncesionarit/shoqërisë koncesionare dhe për llogari të Autoritetit Kontraktor (shtojca 9/1 e marrëveshjes).

2.2 Në klauzolën 2.1 “Dhënia e koncesionit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) germa “a”/“ii”- Palët bien dakord që të ndryshohet si më poshtë:

“administruar, operuar dhe mirëmbajtur të gjithë anën ajrore dhe infrastrukturën (përveç kontrollit të trafikut ajror). Shërbimet në tokë do të ofrohen sipas rregullave në fuqi në Republikën e Shqipërisë ‘Për hyrjen në tregun e shërbimeve të përpunimit në tokë në aeroportet e Republikës së Shqipërisë’.

b) germa “a”/“iv” ndryshohet si vijon:

“iv. përmirësuar, rrugët lidhëse dhe mirëmbajtur pistën dhe zgjerimin e pistës, përfshirë projektimin, financimin, operimin, ndërtimin, vënien në punë, mirëmbajtjen, administrimin dhe zhvillimin e kësaj infrastrukture, sipas kushteve të treguara në pikën 4.8 (Zgjatimi i pistës) dhe shtojcat 23 (Infrastruktura ajrore) dhe 23/1 (Investimet e shoqërisë për periudhën e mbetur të koncesionit), i kontratës së koncesionit.”.

2.3 Germa “a” e klauzolës 2.2 (Afati), i marrëveshjes së koncesionit (të ndryshuar) do të hiqet dhe zëvendësohet me sa më poshtë:

“a) Koncesioni jepet për një afat kohor (tridhjetë e pesë) vjet, duke filluar nga data e fillimit (Afati i koncesionit).”.

2.4 Germa “b” e klauzolës 2.2 (Afati) të marrëveshjes së koncesionit do të ndryshohet si vijon:

“b) Afati i koncesionit mund të zgjatet me marrëveshje me shkrim midis palëve, në rast se është e lejueshme dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.”.

Referencat në paragrafin hyrës “C”, klauzolën “b”/“iv”, klauzolën “d” të marrëveshjes së koncesionit, për afatin kohor prej 22 (njëzet e dy) vjetësh, si dhe kudo tjetër në tekstin e marrëveshjes së koncesionit ku bëhet referencë në afatin e koncesionit, do të konsiderohen të zëvendësuara nga afati kohor prej 35 (tridhjetë e pesë) vjetësh.

2.5 Pas klauzolës 4.4 të shtohet klauzola 4.4.1 me këtë përmbajtje:

“4.4.1 Shoqëria ka detyrimin për të projektuar, ndërtuar, operuar dhe mirëmbajtur ndryshimet në infrastrukturë dhe teknologjinë përkatëse, si dhe për të realizuar investimet e parashikuara në shtojcën që i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje koncesioni si shtojca me nr. 23/1, në përputhje

me afatet e përcaktuara në të. Shoqëria merr përsipër përmbushjen e detyrimeve sipas shtojcës 23/1 bashkëlidhur kësaj kontrate.”.

2.6 Fjalja e parë në germën “a” të klauzolës 4.8 ndryshohet si vijon:

“a) Në çdo rast, Shoqëria do të përgatisë dhe do t’i dorëzojë propozimin për zgjatimin e pistës, Komitetit të Rishikimit të Pavarur, jo më vonë se 90 ditë nga marrja e një kërkesë nga OSHA-ja, apo data e fillimit të detyrimit sipas shtojcës 23/1”.

2.7 Klauzola 4.9, paragrafi “a”, “Certifikata e përfundimit” ndryshohet si më poshtë:

a) Me përmbushjen nga shoqëria të detyrimeve kryesore, detyrimeve shtesë dhe atyre të paraqitura në shtojcën 23/1 (Investimet e shoqërisë për periudhën e mbetur të koncesionit), sipas shtojcës 5 (Sanksionet për mospërmbushje të detyrimeve kryesore.) dhe shtojcës 6 (Sanksionet për mospërmbushje të detyrimeve shtesë) dhe shtojcës 6/1 (Sanksionet për mospërmbushjen e investimeve të shoqërisë për periudhën e mbetur të koncesionit, sipas shtojcës 23/1), në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj kontrate, inxhinieri i pavarur apo inxhinieri i kualifikuar, sipas rastit, do të lëshojnë certifikatën e përfundimit me anë të së cilës konfirmojnë përmbushjen e detyrimeve në përputhje me këtë kontratë.

2.8 Klauzola 9, “Komiteti i pavarur i rishikimit”, ndryshohet si më poshtë:

“9.1 Anëtarët e Komitetit të Pavarur të Rishikimit

“Komiteti i Pavarur i Rishikimit” do të përbëhet si më poshtë:

a) një anëtar, të jetë një nëpunës zyrtar i lartë, do të emërohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë;

b) një anëtar, të jetë një nëpunës zyrtar i lartë, do të emërohet nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën;

c) një anëtar, të jetë një nëpunës zyrtar i lartë i AAC-së, që do të emërohet nga AAC-ja;

d) një anëtar, të jetë partner i një firme ndërkombëtare llogarie, që do të emërohet së bashku nga Shoqëria Koncesionare dhe nga Organi Shtetëror i Autorizuar;

e) një anëtar të jetë:

i. inxhinieri i pavarur, gjatë periudhës së kryerjes së punëve të ndërtimit, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve; ose

ii. një inxhinier i kualifikuar, gjatë periudhës së kryerjes së punëve të ndërtimit, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve shtesë ose, në mungesë të një inxhinieri të tillë të kualifikuar, një përfaqësues nga huadhënësi kryesor; dhe

e) një anëtar të jetë një inxhinier i kualifikuar që do të emërohet nga Shoqëria Koncesionare.

9.2 Detyrat

a) Në rast se nuk parashikohet ndryshe në këtë kontratë, Komiteti i Pavarur i Rishikimit nuk është i detyruar nga rregulla procedurale në përmbushjen e detyrave të tij. Ai do të mblidhet dhe do të:

i. shqyrtojë çdo variant të propozuar të masterplanit të përditësuar të Aeroportit dhe do të bëjë një rekomandim për të;

ii. shqyrtojë çdo projekt për zgjatimin e pistës dhe të bëjë një rekomandim për këtë;

iii. marrë në konsideratë çështje të tjera teknike që kanë lidhje me këtë kontratë ashtu si i referohen atij nga secila prej palëve në mënyrë të arsyeshme.

b) Çdo rekomandim nga Komiteti i Pavarur i Rishikimit për të cilin palët nuk janë marrë vesh mund të referohet për zgjidhje në përputhje me pikën 36 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) nga secila prej palëve.

c) Të gjitha njoftimet për Komitetin e Pavarur të Rishikimit do t’i dërgohen Komitetit të Pavarur të Rishikimit te personi i adresuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar, i cili do të bëjë dorëzimin te Komiteti i Pavarur i Rishikimit. Ky person i adresuar do të jetë i detyruar të komunikojë menjëherë njoftime të tilla te çdo anëtar i Komitetit të Pavarur të Rishikimit.

d) Komiteti i Pavarur i Rishikimit do të mblidhet në Tiranë sipas nevojës.

9.3 Kostot dhe shpenzimet

Kostot dhe shpenzimet e arsyeshme të Komitetit të Pavarur të Rishikimit përballohen nga

Shoqëria Koncesionare. Shoqëria Koncesionare do të dëmshpërblejë çdo anëtar të Komitetit të Pavarur të Rishikimit, për të gjitha kostot e arsyeshme, shpenzimet, detyrimet financiare dhe/ose demet e pësuar prej tij, në lidhje me përmbushjen e detyrave si anëtar i Komitetit të Pavarur të Vlerësimit.”.

2.9 Pas klauzolës 14.2 shtohet klauzola 14.2.1 me përmbajtjen si vijon:

“14.2.1 Sigurimi i përmbushjes së detyrimeve sipas ndryshimeve në këtë Kontratë:

a) Shoqëria Koncesionare i dorëzon OSHA-së përpara momentit të nënshkrimit të këtij amendamenti kontrate, një sigurim kontrate të parevokueshëm dhe të pagueshëm me kërkesën e parë, në formën e një garancie bankare të pakushtëzuar të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, apo shoqëri sigurimesh. Shuma e sigurimit të kësaj kontrate për secilin vit do të jetë në vlerën 5 (pesë) % të vlerës së punimeve ndërtimore të atij viti, e cila do t'i rikthehet mbrapsht Shoqërisë Koncesionare në momentin e dorëzimit të garancisë pasardhëse.

b) Pas përfundimit të periudhës së punimeve deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës, Shoqëria Koncesionare, për përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate, dorëzon sigurimin e kontratës së lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë ose shoqëri sigurimesh, në vlerën 5 (pesë) % të vlerës të shpenzimeve operative vjetore të parashikuara në atë vit, të rinovueshme për çdo vit.

2. Sigurimi i kontratës dhënë si më lart:

a) është një instrument që mbulon të gjitha detyrimet e Koncesionarit, që rrjedhin nga kjo shtesë kontrate, e cila mbahet nga OSHA-ja në rastin e mospërmbushjeve të kontratës nga Shoqëria Koncesionare;

b) emërton OSHA-në si përfitues të drejtpërdrejtë; dhe

c) pas dorëzimit të sigurimit të kontratës tek OSHA-ja, ky i fundit menjëherë nga data e paraqitjes së saj e shqyrton atë, dhe nëse sigurimi i kontratës është në përputhje me parashikimet e mësipërme, OSHA-ja e pranon atë, për çdo periudhë garancie të njëpasnjëshme, të parashikuar në pikën 14.2.1, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

2.10 Në nënpikën “ii”, të germës “c”, të klauzolës 19.1, fraza “taksë kufiri në dalje” zëvendësohet me “tarifa për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”.

2.11 Palët bien dakord që pas shtojcës 6, të shtohet shtojca 6/1:

“SHTOJCA 6/1

SANKSIONET PËR MOSPËRMBUSHJEN E INVESTIMEVE TË SHOQËRISË PËR PERIUDHËN E MBETUR TË KONCESIONIT, SIPAS SHTOJCËS 23/1

Referuar pikës 4.4.1 dhe shtojcës 23/1, sanksioni për mosrealizimin e tyre do të përllogaritet si shumë e sanksionit të zbatueshëm për çdo ditë të mospërmbushjes në vlerën 2000 euro/ditë. Inxhinieri i kualifikuar do të kontrollojë përmbushjen e investimeve, sipas shtojcës 23/1 nga ana e Shoqërisë, nëse i kërkohet një gjë e tillë nga Organi i Autorizuar Shtetëror me shkrim. Shoqëria do t'i lejojë inxhinierit të kualifikuar të hyjë në zonën e koncesionit dhe t'i japë informacionin e nevojshëm sipas kërkesës së inxhinierit të kualifikuar në përmbushjen e detyrës.

Periudha maksimale, për mospërmbushje të ndonjë detyrimi, të ri do të kufizohet në 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë vonese.

Nëse sanksionet për mospërmbushje të ndonjë detyrimi të ri janë të pagueshme nga Shoqëria Koncesionare, në lidhje me ndonjë detyrim të ri për më shumë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, Qeveria e Shqipërisë do të ketë të drejtën të ndërhyjë, nëse e sheh të nevojshme të zgjidhë këtë kontratë, sipas dispozitës 26.3 (Zgjidhja e kontratës nga qeveria e Shqipërisë, për arsye të mospërmbushjes specifike nga ana e Shoqërisë Koncesionare).”.

2.12 Pika 2 e shtojcës 7, “Pagesa për pasagjerët” të ndryshojë si vijon:

“Pagesa bazë për pasagjerët do të jetë EUR 10 (dhjetë) euro për personat mbi 12 vjeç dhe EUR 3 (tre) euro për fëmijë nga 2 deri në 12 vjeç. Pagesa për pasagjerët do të jetë e pagueshme vetëm nga pasagjerët që largohen nga vendi.”.

2.13 Paragrafi i tretë i pikës 2 dhe pika 3 e shtojcës 18, “Masterplani dhe plani i ndërtimeve”, ndryshohen si më poshtë:

2. Dorëzimi i planit kryesor të përditësuar të aeroportit Njesisë së Zbatimit të Projektit

“Shoqëria Koncesionare do të përgatisë azhurnime periodike të masterplani i përditësuar i aeroportit një herë në pesë vjet. Çdo azhurnim periodik do të dorëzohet pranë NJZP-së, e cila do të shprehë qëndrimin dhe rekomandimet e saj brenda 2 muajve nga data e dorëzimit. Pas marrjes së mendimit nga NJZP-ja, masterplani do t’i dorëzohet për miratim KKT-së (apo çdo organi zëvendësues), i cili do të shprehet mbi miratimin ose jo të tij, brenda dy muajve nga data e dorëzimit. Nëse miratimi nuk jepet brenda afatit dymujor, masterplani i përditësuar i aeroportit konsiderohet si i miratuar përderisa Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit (KKT) nuk kundërshton me shkrim masterplanin e përditësuar të aeroportit me pretendime thelbësore.

Në afatet e mësipërme, nuk përfshihet koha e nevojshme e marrë nga shoqëria gjatë këtij procesi, për rishikimet e rekomanduara.

3. Veprimtaritë të jenë në përputhje me masterplanin e përditësuar të aeroportit

Shoqëria do të zhvillojë dhe vërë në funksionim Aeroportin gjatë periudhës së koncesionit, në përputhje me masterplanin e përditësuar të aeroportit të miratuar nga KKT-ja apo çdo institucion zëvendësues i këtij të fundit.”.

2.14 Në pikën 5, shtojca 23, “Infrastruktura nga ana e aerodromit”, fjala “Code D” të zëvendësohet me “Code E”.

2.15 Detyrimet e Shoqërisë Koncesionare për të financuar projektin

Palët bien dakord se Shoqëria Koncesionare, me qëllim përmbushjen e investimeve në cilësinë dhe afatin e përcaktuar në shtojcën 23/1, duhet të marrë masat e nevojshme për të financuar projektin me kredi në institucione vendëse dhe/ose të huaja financiare. Ortaku i Shoqërisë Koncesionare mund të garantojë shlyerjen e kredive/huave të marra, në përputhje me parashikimin si më sipër, duke vendosur barrë mbi kuotat e Shoqërisë Koncesionare. Shoqëria Koncesionare ka detyrimin të sigurojë OSHA-në me kopje të dokumentacionit të financimit.

3. INTERPRETIMI

3.1 Në këtë ndryshim, të gjithë termat dhe përkufizimet e përdorur, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në formë të shprehur në këtë ndryshim, do të kenë të njëjtin kuptim si termat dhe përkufizimet e përcaktuar dhe interpretuar në marrëveshjen fillestare të koncesionit. Parimet e interpretimit, të përcaktuara në pikën 1.2 (Interpretimi) të marrëveshjes së koncesionit, do të kenë të njëjtin efekt sikur të ishin përcaktuar në këtë ndryshim. Dispozitat e marrëveshjes fillestare të koncesionit, përveç atyre të ndryshuara nga ky ndryshim, do të vazhdojnë të kenë fuqi dhe efekt të plotë.

3.2 Në rast se ndonjë dispozitë e këtij ndryshimi anulohet, bëhet e paligjshme ose e pazbatueshme, sipas një juridiksioni të caktuar, ky anulim, paligjshmëri ose pazbatueshmëri nuk do të prekë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të këtij ndryshimi ose të ndikojë në vlefshmërinë, ligjshmërinë apo zbatueshmërinë e dispozitave në çdo juridiksion tjetër.

3.3 Palët bien dakord, se në rast të një mosmarrëveshjeje apo pretendimi, e/i cila/i lind si rezultat apo në lidhje me këtë ndryshim, neni 36 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) e marrëveshjes fillestare të koncesionit do të aplikohet, *mutatis mutandis*.

3.4 Detyrimet e sigurimit për operimin e Shoqërisë do të shtrihen përgjatë gjithë periudhës së koncesionit.

4. LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Ky ndryshim dhe çdo detyrim jokontraktual, i cili mund të lindë nga/apo në lidhje me këtë ndryshim do të rregullohet sipas ligjit anglez.

5. GJUHA

Ky ndryshim do të nënshkruhet në gjuhën shqipe me përkthimin e sigluar në gjuhën angleze bashkëngjitur si një pjesë integrale e tij. Në rast mospërputhjeje ndërmjet përkthimit të ndryshimit në gjuhën angleze të sigluar dhe tekstit shqip të këtij ndryshimi, përkthimi anglisht i këtij ndryshimi do të mbizotërojë. Çdo dokument i përmendur në këtë ndryshim ose që duhet të

dorëzohet sipas këtij ndryshimi do të jetë në gjuhën angleze dhe/ose në gjuhën shqipe, sipas nevojës.

6. TËRËSIA E KONTRATËS

6.1 Ky ndryshim përbën të gjithë marrëveshjen ndërmjet palëve, në lidhje me objektin e tij dhe mbizotëron çdo marrëveshje apo mirëkuptimi të mëparshëm të shkruar apo verbal, si dhe çdo mirëkuptimi apo marrëveshje aktuale verbale ndërmjet palëve në lidhje me këtë objekt. Ai përbën shprehjen e mirëkuptimit përfundimtar, të plotë dhe ekskluziv të palëve në lidhje me çështjet e përshkruara në këtë dokument. Palët pranojnë se për lidhjen e këtij ndryshimi nuk janë bazuar në asnjë deklaratë apo garanci tjetër përveç atyre të shprehura në këtë ndryshim.

6.2 Një kopje e këtij ndryshimi, i bashkëlidhet marrëveshjes së koncesionit, duke u bërë pjesë integrale dhe e pandashme e saj. Të gjitha parashikimet e marrëveshjes së koncesionit që nuk preken nga ky ndryshim, qëndrojnë në fuqi e do të zbatohen për sa është e aplikueshme dhe jo në kundërshtim me këtë ndryshim.

7. KOPJET

Ky ndryshim do të nënshkruhet në pesëmbëdhjetë kopje të njëjta dhe të gjitha së bashku do të konsiderohen të përbëjnë një dhe të njëjtin dokument.

8. NËNSHKRIMI

Palët nënshkruajnë këtë ndryshim në datën _____. Ky ndryshim hyn në fuqi pasi të ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Znj. Anila Denaj

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Z. Etjen Xhafaj

Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Me autorizim

Për Tirana International Airport sh.p.k.

Constantin Von Alvensleben

SHTOJCA 6/1

SANKSIONET PËR MOSPËRMBUSHJEN E INVESTIMEVE TË SHOQËRISË PËR PERIUDHËN E MBETUR TË KONCESIONIT, SIPAS SHTOJCËS 23/1

Referuar pikës 4.4.1 dhe shtojcës 23/1, sanksioni për mosrealizimin e tyre do të përlogaritet si shumë e sanksionit të zbatueshëm për çdo ditë të mos përmbushjes në vlerën 2000 euro/ditë.

Inxhinieri i kualifikuar do të kontrollojë përmbushjen e INVESTIMEVE SIPAS SHTOJCËS 23/1 nga ana e Shoqërisë nëse i kërkohet një gjë e tillë nga Organi i Autorizuar Shtetëror me shkrim. Shoqëria do t'i lejojë inxhinierit të kualifikuar të hyjë në zonën e koncesionit dhe t'i japë informacionin e nevojshëm sipas kërkesës së inxhinierit të kualifikuar në përmbushjen e detyrës. Periudha maksimale për mospërmbushje të investimeve të Shoqërisë për periudhën e mbetur të koncesionit, sipas shtojcës 23/1, do të kufizohet në 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë vonesë.

Nëse sanksionet për mospërmbushje të investimeve të Shoqërisë për periudhën e mbetur të koncesionit, sipas shtojcës 23/1, janë të pagueshme nga Shoqëria në lidhje me ndonjë detyrim të ri për më shumë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, Qeveria e Shqipërisë do të ketë të drejtën të ndërhyjë nëse e sheh të nevojshme të zgjidhë këtë kontratë sipas dispozitës 26.3 (Zgjidhja e kontratës nga Qeveria e Shqipërisë për arsye të mospërmbushjes specifike nga ana e Shoqërisë).

SHTOJCA 9/1

GARANCIA E PËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE TË SHOQËRISË SIPAS

KËRKESËS

[Letër me kokë e Bankës/kompanisë së sigurimeve]

Për:

Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Qeverisë së Shqipërisë
Tiranë, Shqipëri (Ministria e Financave dhe Ekonomisë)

dhe

Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë
Tiranë
Shqipëri
(Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)

(Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,
bashkërisht “Organi Shtetëror i Autorizuar” në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës së
Shqipërisë)

[Vendi dhe data]

Të nderuar zotërinj,

Garancia e përmbushjes No. [•]

Për arsye se [emri shoqërisë] (Shoqëria) ka hyrë në një kontratë koncesioni me Qeverinë e Shqipërisë, të përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar (Qeveria e Shqipërisë), me [•] 2004 (Kontratë e koncesionit) për disenjimin, financimin, ndërtimin, administrimin dhe zhvillimin e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë, Republika e Shqipërisë, të përshkruar më tej në kontratën e koncesionit.

Për arsye se ndryshimi i marrëveshjes së koncesionit përmban një detyrim për Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare të paraqesë një garanci në favor të Qeverisë së Shqipërisë, në shumën _____ euro, sipas përcaktimeve të klauzolës 14.2.1 të kontratës së koncesionit, të ndryshuar.

Ne, [emri Bankës/ i Shoqërisë së sigurimit], deklarojmë se:

- jemi garantuesit e kontratës së sipërpërmendur deri në shumën totale prej (shuma në shifër dhe fjalë), shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në kontratë; dhe
- marrim përsipër të paguajmë, sapo të bëni kërkesën e parë me shkrim dhe pa qenë nevoja të bëni argumentim të kërkesës, çdo shumë brenda kufirit prej (shuma e garancisë); dhe
- për marrjen e kësaj garancie, nuk është nevoja t’i drejtoheni më parë koncesionarit/Shoqërisë koncesionare për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj; dhe
- asnjë shtesë apo ndryshim i kushteve të kontratës, për të cilën ju mund të bini dakord me koncesionarin/Shoqërinë koncesionare, nuk na çliron nga detyrimet e kësaj garancie.

Kjo garanci është e vlefshme deri në datën _____.

Ky sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës/kompanisë së sigurimeve]

SHTOJCA 23/1

INVESTIMET E SHOQËRISË PËR PERIUDHËN E MBETUR TË KONCESIONIT

1. Detyrimet e Shoqërisë që do të realizohen në formën e investimeve dhe grafikut të parashikuar të realizimit:

Referuar pikës 4.4.1 të kontratës së koncesionit, Shoqëria ka detyrimin që të realizojë investimet e mëposhtme:

	Përshkrimi i investimit	Vlera (euro)	Koha e planifikuar për fillimin e investimit	Afati maksimal i përfundimit të investimit
1	Rehabilitim strukturor dhe riveshja e pistës ekzistuese dhe rregullimi i sistemit aktual të drenazhimit	16,400,000	2021	2021
2	Zgjatimi i pistës	4,450,000	2025	2026
3	Zgjerimi i terminalit	23,800,000	2024	2026
4	Përmirësimi dhe rinovimi i terminalit aktual bashkë me pajisjet e sigurisë brenda terminalit	8,400,000	2024	2026
5	Zëvendësimi i sistemit aktual CCTV me një sistem me teknologji të avancuar me sistem alarmi dhe sensor për çdo lëvizje të dedikuar	6,000,000	2030	2032
6	Zëvendësimi i rrethimit ekzistues me një rrethim të standardeve të fundit evropiane, me sistem të inkuorporuar të detektimit të prezencës së kërcënimit nga jashtë dhe zgjatimi i rrethimit	3,000,000	2028	2030
7	Ndërtesa e re e zjarrfikëses	1,000,000	2021	2021
8	Zjarrfikëset e reja dhe pajisjet për godinën e zjarrfikëses	2,500,000	2025	2026
9	Përmirësimi dhe riveshja e <i>Taxiway Delta</i>	2,300,000	2021	2021
10	Shtimi i 4 posteve të parkimit në <i>Apron</i>	5,500,000	2025	2026
11	Rinovimi i ndriçimit të pistës	5,000,000	2030	2031
12	Shtimi i parkingut për makinat e pasagjerëve dhe mjetet e transportit urban	3,000,000	2032	2033
13	Sistem i ri drenazhi për të gjithë sipërfaqen e koncesionit	4,000,000	2030	2032
14	Rehabilitim strukturor dhe riasfaltim përfundimtar i pistës dhe <i>Taxiway</i>	14,000,000	2038	2039
	TOTALI	99,350,000		

Shënim. Vlera e investimeve të parashikuara në tabelën e mësipërme është bazuar në manualet e miratuara të ndërtimeve dhe mbi bazë të çmimeve mesatare të tregut. Këto investime nuk kufizojnë detyrimin e shoqërisë për të kryer investime të reja, në përmbushje të detyrime kryesore, detyrimeve shtesë, shtojcave të kësaj kontrate ose që përbëjnë veprim korrigjues të rezultuar për papajtueshmëri të evidentuara nga aktivitetet monitoruese të autoriteteve rregullatore kompetente. Për të shmangur çdo keqkuptim, vlerat e investimit të përcaktuara në këtë shtojcë 23/1, nuk përfshijnë vlerat që lidhen me detyrimin e shoqërisë për mirëmbajtje dhe riparime të vazhdueshme.

PALËT

NOTERE